


ANALIZË E SISTEMIT
BANKAR SHQIPTAR
NËN KËNDVËSHTRIMIN
RREZIK – PERFORMANCË

Irini Kalluci*

03 (46) 2011

MATERIALI DISKUTIMI



BANKA E SHQIPËRISË

** Iri Kalluci: Departamenti i Kërkimeve, Banka e Shqipërisë,
e-mail: ikalluci@bankofalbania.org*

*Mendimet e shprehura në këtë studim janë të autorit dhe nuk përfaqësojnë
domosdoshmërisht ato të Bankës së Shqipërisë.*

PËRMBAJTJA

<i>Abstrakt</i>	5
<i>1. Hyrje</i>	8
<i>2. Analiza e raporteve financiare sipas modelit të modifikuar DuPont</i>	9
<i>3. Analiza në formë matrice e performancës së sistemit bankar</i>	25
<i>4. Indeksi i rrezikut</i>	32
<i>5. Përfundime</i>	39
<i>Referenca</i>	41
<i>Shtojca</i>	43

ABSTRAKT

Industria bankare përbën segmentin më të rëndësishëm të sistemit financiar shqiptar dhe si i tillë, kërkon një vëmendje më të madhe kur bëhet fjalë për analizat financiare të tij. Ky material trajton teorikisht dhe analitikisht, tregues të rrezikut dhe kthimit, si dhe për herë të parë, paraqet metodologjinë e përlogaritjes së një indeksi rreziku për sistemin bankar shqiptar. Qëllimi i këtij punimi është jo thjesht të analizojë raportet financiare apo matësit e rrezikut dhe performancës, por mbi të gjitha të sugjerojë disa tregues dhe një indeks, të cilët mund të përdoren nga mbikëqyrësit gjatë punës së tyre.

LISTA E SHKURTIMEVE

Shkurtimi	Kuptimi	Emërtimi në anglisht
AU	Përdorimi i aktiveve	Asset Utilization
B	Barra e bankës	Burden
BVE	Kapitali aksioner	Book Value of Equity
COL	Kostoja mesatare e detyrimeve	Cost of Liabilities
EA	Aktive që sjellin të ardhura	Earning Assets
EAER	Raporti i aktiveve që sjellin të ardhura me kapitalin aksioner	Earning Assets to Equity Ratio
EAR	Raporti i aktiveve që sjellin të ardhura me aktivet totale	Earning Assets Ratio
EAT	Rezultati neto	Earnings After Taxes
EM	Shumëzuesi i kapitalit	Equity Multiplier
ER	Raporti i shpenzimeve	Expenses Ratio
IE	Shpenzime për interesa	Interest Expenses
INIR	Raporti i të ardhurave nga interesat me të ardhurat jo nga interesat	Interest to Non-Interest Ratio
IOA	Të ardhura nga interesat ndaj aktiveve totale	Interest on Assets
IOE	Të ardhura nga interesat ndaj kapitalit aksioner	Interest on Equity
IR	Të ardhura nga interesat	Interest Revenues
ITIR	Raporti i të ardhurave nga interesat me të ardhurat totale	Interest to Total Income Ratio
LEA	Raporti i pasiveve që paguajnë interes me aktivet që sjellin të ardhura	Liabilities to Earning Assets
LLP	Shpenzime për provigjone	Loan Loss Provisions
NEIR	Raporti i rezultatit neto ndaj të ardhurave nga interesat	Net Earnings to Interest Ratio
NENII	Raporti i rezultatit neto ndaj rezultatit neto nga interesat	Net Earnings to Net Interest Income
NENIR	Raporti i rezultatit neto ndaj të ardhurave jo nga interesat	Net Earnings to Non-Interest Ratio
NIE	Shpenzime jo për interesa	Non Interest Expenses
NIEA	Të ardhura jo nga interesat ndaj aktiveve që sjellin të ardhura	Non-Interest on Earning Assets
NII	Rezultati neto nga interesat	Net Interest Income

NIIOE	Rezultat neto nga interesat ndaj kapitalit aksioner	Net Interest Income on Equity
NIIR	Raporti i rezultatit neto me të ardhurat totale nga interesat	Net Interest to Interest Ratio
NIRTIR	Raporti i të ardhurave jo nga interesat me të ardhurat totale	Non-Interest Revenues to Total Income Ratio
NIM	Marzhi neto i interesave	Net Interest Margin
NINIR	Raporti i rezultatit neto nga interesat me të ardhurat totale jo nga interesat	Net Interest to Non-Interest Ratio
NIOA	Të ardhura jo nga interesat ndaj aktiveve totale	Non-Interest on Assets
NIOE	Të ardhura jo nga interesat ndaj kapitalit aksioner	Non-Interest on Equity
NIR	Të ardhura jo nga interesat	Non-Interest Revenues
NITIR	Raporti i rezultatit neto nga interesat me të ardhurat totale	Net Interest to Total Income Ratio
NNII	Rezultati neto jo nga interesat	Net Non-Interest Income
NOI	Të ardhura neto të veprimtarisë	Net Operating Income
NREA	Raporti i rezultatit neto me aktivet që sjellin të ardhura	Net Return on Earning Assets
PL	Pasive që shkaktojnë shpenzime	Paying Liabilities
PM	Marzhi i fitimit	Profit Margin
REA	Kthimi nga aktivet që sjellin të ardhura	Return on Earning Assets
ROA	Kthimi nga aktivet	Return on Assets
ROE	Kthimi nga kapitali aksioner	Return on Equity
T	Shpenzime për taksa dhe tatime	Taxes
TA	Totali i aktiveve	Total Assets
TIEA	Të ardhura totale ndaj aktiveve që sjellin të ardhura	Total Income on Earning Assets
TIOE	Të ardhura totale ndaj kapitalit aksioner	Total Income on Equity
TOE	Shpenzime totale	Total Operating Expenses
TOI	Të ardhura totale	Total Operating Income

1. HYRJE

Kohët e fundit, ndikuar edhe nga situatat e vështira që po përjetojnë tregjet financiare që prej vitit 2007, i është kushtuar një vëmendje e madhe çështjeve që lidhen me sigurinë dhe stabilitetin e sistemit financiar në tërësi dhe sidomos atij bankar në veçanti, si segmenti kryesor i tij. Janë shtuar masat për një mbikëqyrje më të rreptë si dhe është rritur kujdesi gjatë analizave të performancës dhe rrezikut të bankave. Këto analiza janë të dobishme dhe shihen me interes nga të gjitha palët e interesuara e jo vetëm nga rregullatorët e mbikëqyrësit. Në dallim nga analizat tradicionale të treguesve bankarë që përdoren në raportet vjetore të mbikëqyrjes bankare, në këtë punim përfshihen edhe elemente shtesë të parë në një tjetër këndvështrim, për sistemin bankar shqiptar.

Seksioni në vijim zbërthen treguesin ROE nëpërmjet modelit të modifikuar DuPont dhe identifikon faktorët që ndikojnë më shumë në këtë tregues. Në seksionin e tretë, ndërtohet një matricë treguesish të vlefshëm për analizat financiare të sistemit bankar. Seksioni i katërt përshkruan metodologjinë dhe llogarit për herë të parë Indeksin e Rrezikut për sistemin bankar shqiptar, bazuar në modelin e përfutur nga Hannan dhe Hanweck (1988) dhe të aplikuar më pas edhe nga autorë të tjerë. Në seksionin e pestë paraqiten disa përfundime.

2. ANALIZA E RAPORTEVE FINANCIARE SIPAS MODELIT TË MODIFIKUAR DUPONT

Matja dhe analiza e raporteve që japin një pamje më të qartë të situatës financiare të bankave, po marrin gjithmonë e më tepër rëndësi, sidomos në kushtet kur përpjekjet për ruajtjen e stabilitetit financiar janë në plan të parë. Gjithashtu, analizat paraprake të treguesve financiarë krijojnë një ide mbi ecurinë e sistemit bankar dhe paralajmërojnë për ndonjë situatë jo të pëlqyeshme në të ardhmen.

2.1 NJË VËSHTRIM I SHPEJTË MBI MODELIN DUPONT

Pikënisja e matjes dhe analizës së treguesve financiarë të një ndërmarrjeje (apo industrie) është norma e kthimit nga kapitali (ROE), që shpreh përfitimin e siguruar gjatë një periudhe kohore, nga këndvështrimi i aksionerëve.

Modeli DuPont i krijuar që në vitin 1919, në ditët e sotme përdoret gjerësisht pothuajse në të gjitha industritë dhe shërben si modeli bazë me anën e të cilit mundësohet një analizë e detajuar e raportit të kthimit nga kapitali dhe faktorëve që e ndikojnë atë. Arsyeja pse ky model i ka rezistuar kohës, lidhet me faktin se ai shërben për dy qëllime kryesore: së pari, për të bërë një analizë të faktorëve që ndikojnë rentabilitetin dhe për të krahasuar një biznes me një tjetër apo me gjithë industrinë; dhe së dyti, për të lehtësuar analizën e ecurisë që përdoret në identifikimin e burimit të një ndryshimi në rentabilitet dhe për të marrë masa korrigjuese para se të jetë tepër vonë (Walker, 2007). Ndërsa profesor Stephen Jablonsky është shprehur se “Modeli DuPont është një mënyrë e bërjes së dukshëm të informacionit, në mënyrë që çdokush të mund ta shikojë”.

Modeli (ekuacioni) DuPont e shpërbën treguesin ROE në disa elemente përbërëse, duke ndjekur tre hapa:

Hapi i parë:

Në këtë fazë, kthimi nga kapitali aksioner zërthehet në dy komponentë; kthimi nga aktivet (ROA) dhe leva financiare (ose siç quhet ndryshe shumëzuesi i kapitalit - EM):

$$ROE = ROA * EM \quad (1)$$

Hapi i dytë:

Faza e dytë e zërthimit të ROE, konsiston në shpërbërjen e ROA në dy komponentë të tjerë, përkatësisht marzhin e fitimit (PM) dhe përdorimin e aktiveve (AU):

$$ROA = PM * AU \quad (2)$$

Hapi i tretë:

Kjo fazë lidhet me krijimin e disa raporteve të reja nisur nga elementet përbërëse të numëruesit apo emëruesit të treguesve, të gjeneruar në hapat e mëparshëm dhe të përshtatur sipas karakteristikave të çdo industrie.

2.2 METODOLOGJIA E ZBËRTHIMIT TË TREGUESIT ROE PËR SISTEMIN BANKAR

Cole (1972) ishte i pari që përshtati dhe zbatoi modelin DuPont edhe për bankat. Sistemi bankar vepron si çdo industri tjetër në një treg të rregulluar, të mbikëqyrur dhe me konkurrencë. Ai ka produktet dhe shërbimet e veta që e bëjnë të dallueshëm nga industritë e tjera. Edhe pasqyrat financiare të sistemit bankar ndryshojnë nga ato të sektorëve të tjerë, për nga veçantitë që karakterizojnë veprimtarinë bankare. Si pasojë, raportet financiare apo ekonomike mbi eficiencën e funksionimit dhe performancën e bankave, do të marrin një tjetër kuptim kur përlllogariten për këtë sektor.

Cole (1972) ishte i mendimit se mund të ketë edhe mënyra të tjera më realiste të matjes së performancës së bankave përveç normës së rritjes së të ardhurave neto apo fitimit për aksion. Dhe në punimin e tij, ai sugjeron pikërisht një tjetër tregues që mund të përdoret për këtë qëllim – raportin e kthimit nga kapitali aksioner - si elementin

filleshtar ku nisin dhe zhvillohen gjithë analizat financiare. Siç mund të shihet edhe nga ekuacioni (3), kjo normë tregon nivelin e fitimit neto të gjeneruar nga kapitali i investuar në bankë. Një vlerë e lartë e ROE, zakonisht tregon për një situatë më të qëndrueshme dhe më të sigurt të bankës. Por, një vlerë e lartë e këtij treguesi mund të shkaktohet nga një nivel i ulët i kapitalit (gjë që është jo e pëlqyeshme) ose nga një nivel i lartë i fitimit të periudhës. Nga ana tjetër, një vlerë e njëkohshme negative e kapitalit aksioner dhe e fitimit neto, do të sillte një ROE pozitive.

$$ROE = \frac{\text{Rezultati neto}}{\text{Kapitali aksioner mesatar}} = \frac{EAT}{BVE} \quad (3)$$

Në këto kushte, për të shmangur pamjet çorientuese që mund të shkaktojnë në disa raste kthimi nga kapitali, ky tregues i matjes së eficiencës së përdorimit të kapitalit aksioner, mund të shkruhet si kombinim i dy elementeve përbërëse (EM dhe ROA) ¹, ku vetë ROA shpërbëhet në dy indikatorë të tjerë (PM dhe AU)².

$$EM = \frac{\text{Aktive mesatare}}{\text{Kapitali aksioner mesatar}} = \frac{TA}{BVE} \quad (4)$$

Treguesi i shumëzuesit të kapitalit (EM) shpreh sa njësi aktive bankat disponojnë, për çdo njësi kapitali të investuar nga aksionerët dhe është raporti i anasjelltë i "Kapitalit aksioner mesatar / Aktive mesatare" që tregon shkallën e kapitalizimit të bankave. Në fakt, EM na jep indikacione të nevojshme për levën financiare të bankës, ndërsa treguesi $(1 - 1/EM) = \text{Borxh} / \text{Aktive mesatare}$, tregon nivelin e detyrimeve të bankës. Një nivel i lartë i shumëzuesit të kapitalit, tregon për një financim më të lartë me borxh të aktivitetit bankar (pra që sistemi bankar po pranon më shumë depozita, por ka edhe më shumë mundësi për të fituar të ardhura).

¹ Shiko ekuacionin (1)

² Shiko ekuacionin (2)

Ndërsa kthimi nga aktivet (ROA) mund të shprehet si:

$$ROA = \frac{\text{Rezultati neto}}{\text{Aktive mesatare}} = \frac{EAT}{TA} \quad (5)$$

Treguesi ROA tregon sa mirë janë përdorur aktivet e bankës në drejtim të gjenerimit të fitimit. Një vlerë e lartë e tij konfirmon se banka e ka ndërtuar në mënyrën e duhur portofolin e aktiveve të saj, duke kontribuar në sigurimin e fitimeve më të larta.

Është mirë që të shikohen të dy raportet financiare, si ROA ashtu edhe ROE. Megjithëse ndryshojnë nga njëri-tjetri dhe shprehin dy gjëra të ndryshme, ata mbeten të dy tregues të efektivitetit të menaxhimit për të gjeneruar të ardhura si nga paratë e investuara nga aksionerët, ashtu edhe nga totali i investimeve të bëra në formën e aktiveve. Ndërsa ROE nuk tregon gjë për situatën e financimit me borxh, ROA e bën këtë. Ja pse të dy këta tregues plotësojnë njëri-tjetrin.

Studiues të ndryshëm e kanë shpërbërë treguesin ROA në dy elemente të tjera përbërëse dhe të rëndësishme, për të thelluar më tej analizën financiare dhe për të identifikuar faktorët që e përcaktojnë:

$$PM = \frac{\text{Rezultati neto}}{\text{Të ardhurat totale}} = \frac{EAT}{TOI} \quad (6)$$

dhe

$$AU = \frac{\text{Të ardhura totale}}{\text{Aktive mesatare}} = \frac{TOI}{TA} \quad (7)$$

Marzhi i fitimit (PM) shpreh marrëdhënien midis rezultatit neto dhe të ardhurave totale të sistemit bankar. Cole (1972) sugjeron zbërthimin e numëruesit të këtij treguesi në elementet përbërëse të të ardhurave dhe shpenzimeve të shprehur si përqindje e të ardhurave totale, për të parë se cili prej zërave jep kontributin më të madh të marzhi i fitimit.

Ndërsa elementi i dytë, shkalla e përdorimit të aktiveve (AU), tregon lidhjen midis të ardhurave totale dhe aktiveve mesatare, duke shprehur në njëfarë mënyre, kthimin bruto nga aktivet mesatare.

Në këtë punim, do të realizohet një analizë më e detajuar e treguesit të kthimit nga aktivet, duke përdorur një kombinim të dy modeleve; njërit të propozuar nga Koch dhe MacDonald (2002) dhe tjetrit të propozuar nga Vensel et al. (2004). Të dy modelet janë vazhdim dhe modifikim i modelit DuPont të përmendur më lart. Në analizën e ofruar nga këta autorë përfshihen më shumë tregues, të cilët japin një kuadër më të qartë të faktorëve që ndikojnë kthyeshmërinë e sistemit bankar.

Fillimisht Koch dhe MacDonald (2002) shprehin raportin ROE si kombinim të ROA dhe EM. Më pas zbërthejnë ROA në dy tregues, të menaxhimit të të ardhurave dhe të kostove, sipas ekuacionit të mëposhtëm:

$$ROA = AU - ER \quad (8)$$

ku, AU - është shkalla e përdorimit të aktiveve e përmendur edhe më lart; dhe ER – shpreh raportin e shpenzimeve. Ndërsa treguesi i parë (AU) shërben si një përafrues i menaxhimit të të ardhurave, treguesi i dytë (ER) shpreh cilësinë e menaxhimit të shpenzimeve.

Duke u nisur nga ekuacioni (8), mund të vazhdohet më tej me një zbritim të treguesve AU dhe ER³:

$$AU = \frac{TOI}{TA} = \frac{IR + NIR}{TA} \quad (9)$$

dhe

$$ER = \frac{TOE}{TA} = \frac{IE + NIE + LLP + T}{TA} \quad (10)$$

³ Për kuptimin e akronimeve përgjatë studimit, referojuni listës së shkurtimeve.

Nënzërat e të ardhurave dhe shpenzimeve totale të vendosur në raport me aktivet mesatare të bankave, pas disa transformimesh, formojnë tregues të rëndësishëm, të cilët duhen analizuar më tej. Kështu, treguesi ROA mund të shkruhet:

$$ROA = AU - ER = \frac{(IR - IE) + (NIR - NIE) - LLP - T}{TA} = \frac{NII + NNII - LLP - T}{TA} \quad (11)$$

Më pas vazhdohet me transformimin e treguesve përkatës:

$$\frac{NII}{TA} = \frac{NII}{EA} * \frac{EA}{TA} = NIM * EAR \quad (12)$$

dhe

$$B = \frac{NNII}{TA} = \frac{NIR - NIE}{TA} \quad (13)$$

Raporti EAR është një tregues i rëndësishëm i eficiencës dhe strategjive të investimit të bankës në aktive fitimprurëse, duke treguar se ç'pjesë e aktiveve totale janë investuar në aktive që sjellin të ardhura. Barra e bankës për mosmbulimin e shpenzimeve jo për interesa, me të ardhura jo nga interesat (B), shpreh shkallën e menaxhimit të shpenzimeve të veprimtarisë. Zakonisht vlera e saj është negative, pasi të ardhurat jo nga interesat (nga komisionet, nga veprimet me letrat me vlerë, nga veprimet valutore etj.) nuk arrijnë të mbulojnë shpenzimet jo për interesa (shpenzime për paga apo shpenzime të tjera administrative, shpenzime për qira etj.). Marzhi neto i interesave (NIM) është një tjetër faktor i rëndësishëm që mat eficiencën e ndërmjetësimit të bankave dhe shpreh fitimin e gjeneruar për çdo njësi të aktiveve të investuara në aktivitete fitimprurëse. Ky tregues, meqenëse mat edhe burimin kryesor të kthimit të bankave, duhet analizuar më në detaje, duke e shpërbërë në disa raporte përbërës:

$$NIM = \frac{IR}{EA} - \frac{IE}{PL} * \frac{PL}{EA} = REA - COL * LEA \quad (14)$$

REA shpreh kthimin mesatar nga aktivet që sjellin të ardhura (në terma bruto, pra para se të zbriten shpenzimet), duke na dhënë një

normë mesatare të interesit të fituar nga fondet e investuara në kredi, letra me vlerë të qeverisë apo aksione. COL mund të konsiderohet si kosto mesatare e fondeve të marra borxh (e detyrimeve), pasi shpreh pikërisht raportin e shpenzimeve të paguara për interesa, me pasivet mesatare që shkaktojnë shpenzime. Treguesi i fundit (LEA) shpreh intensitetin e investimit të bankës, pra ç'pjesë e pasiveve që paguajnë interes investohet në aktive që sjellin interes.

Përfundimisht, ROA dhe ROE mund të shprehen:

$$ROA = (REA-COL*LEA) * EAR + B - \frac{LLP}{TA} - \frac{T}{TA} \quad (15)$$

$$ROE = [(REA-COL*LEA) * EAR + B - \frac{LLP}{TA} - \frac{T}{TA}] * EM \quad (16)$$

2.3 ANALIZA E PERFORMANCËS SË SISTEMIT BANKAR SHQIPTAR, SIPAS MODELIT TË MODIFIKUAR DUPONT

Tabela 1 paraqet treguesit e kthimit nga kapitali dhe nga aktivet, gjatë viteve 2005-2008, për sistemin bankar shqiptar dhe për disa vende të rajonit, për muajt dhjetor të çdo viti.

Tabelë 1. Krahasimi i treguesve ROE dhe ROA për disa vende të rajonit.

Shteti	Kthimi nga kapitali, në % (ROE)				Kthimi nga aktivet, në % (ROA)			
	2005	2006	2007	2008	2005	2006	2007	2008
Shqipëria	22.4	20.2	20.3	11.4	1.4	1.4	1.6	0.9
Bosnje-Hercegovina	6.2	8.5	8.9	4.3	0.7	0.9	0.9	0.4
Bullgaria	21.4	25	24.8	23.1	2	2.2	2.4	2.1
Kroacia	15.1	12.7	10.9	10.1	1.6	1.5	1.6	1.6
Çekia	26.4	23.4	25.4	21.7	1.4	1.2	1.3	1.2
Maqedonia	7.5	12.3	15.0	12.5	1.2	1.8	1.8	1.4
Mali i Zi	4.2	6.8	6.2	-6.9	0.8	1.1	0.7	-0.6
Rumania	15.4	13.6	11.5	18.1	1.9	1.7	1.3	1.7
Serbia	6.7	10.0	10.2	10.7	1.1	1.7	1.7	2.1
Greqia	15.9	12.7	14.8	3.0	0.9	0.8	1.0	0.2
Italia	9.7	14.3	12.8	4.8	0.7	0.8	0.8	0.3

Burimi: Global Financial Stability Report (IMF), Tetor 2009; BSH për Shqipërinë.

Siç mund të shihet, Shqipëria qëndron ndër vendet me kthime më të larta nga kapitali aksioner, duke dëshmuar për një efektivitet të lartë të përdorimit të tij. Njëkohësisht, mund të thuhet se edhe kthimi nga aktivet ka vlera të kënaqshme dhe të krahasueshme me vendet e rajonit, çka mbështet më shumë pikëpamjen se sistemi bankar shqiptar ka arritur rezultate financiare të kënaqshme gjatë viteve të fundit, si pasojë e investimeve në aktivitete me kthyeshmëri të lartë. Megjithatë, në vitin 2008 të dy këta tregues kanë pësuar rënie të ndjeshme. Madje nëse do të shihen për banka të veçanta, rezulton se në fundvitin 2008 është dyfishuar numri i bankave që kanë pasur kthime negative nga aktivet dhe nga kapitali aksioner (numri i bankave me rezultat negativ është rritur nga 4 në fundin e vitit 2007, në 8 për fundin e vitit 2008)⁴.

Në seksionin 2.2 u përshkrua gjenerimi i disa treguesve të rëndësishëm financiarë nëpërmjet një sërë transformimesh dhe zbërthimesh, bazuar në Koch dhe MacDonald (2002) dhe Vensel et al. (2004), duke marrë si pikënisje raportin e kthimit nga kapitali (ROE). Këta tregues të krijuar, nëpërmjet analizës së ecurisë së tyre në vite, nëse do të llogariten edhe për sistemin bankar shqiptar, mund të na japin një pamje më të qartë të situatës së tij financiare. Ndryshimet e ndodhura në vitet e fundit në sistemin bankar shqiptar (privatizimi i bankave, blerjet e bankave vendase nga banka të huaja të fuqishme, bashkimi i dy bankave, ndryshimet rregullative dhe forcimi i mbikëqyrjes nëpërmjet kërkesave rregullative më strikte, zgjerimi i gamës së produkteve dhe shërbimeve, rritja e konkurrencës etj.) padyshim që kanë ndikuar edhe treguesit që do të analizohen në vijim.

Tabela 2 paraqet zbërthimin e treguesve të kthimit nga kapitali dhe nga aktivet, fillimisht sipas modelit DuPont dhe më pas sipas modeleve të sugjeruar nga Koch dhe MacDonald (2002) dhe Vensel et al. (2004). Të dhënat i përkasin pasqyrave financiare të sistemit bankar shqiptar⁵. Zërat e bilancit që janë përdorur në analizë (totali i aktiveve, kapitali aksioner, aktivet që sjellin të ardhura,

⁴ Shiko grafikët 7 dhe 8.

⁵ Tabela 5 paraqet një model të thjeshtuar të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve të sistemit bankar shqiptar për vitet 2001-2008, në të cilën janë bërë disa transformime për ta përshtatur edhe me pasqyrat financiare të përdorura nga autorë të huaj, gjatë analizës së kthimit nga kapitali.


Tabelë 2. Ecuria e elementeve përbërëse të treguesit ROE në vitet 2001-2008.

Raportet financiare	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Kthimi nga kapitali aksioner (në %), ROE= EAT/BVE	23.45	19.20	19.53	21.10	22.43	20.17	20.32	11.35
Kthimi nga aktivet mesatare (në %), ROA= EAT/TA	1.58	1.20	1.24	1.28	1.41	1.36	1.48	0.91
Komponentët përbërës të ROE, ROE=PM*AU*EM								
Marzhi i fitimit (në %), PM=EAT/TOI	15.99	14.23	14.29	15.80	17.24	17.67	17.95	10.43
Shkalla e përdorimit të aktiveve (në %), AU=TOI/TA	9.90	8.46	8.66	8.08	8.15	7.70	8.24	8.76
Shumëzuesi i kapitalit (në herë), EM=TA/BVE	14.81	15.94	15.78	16.54	15.96	14.82	13.74	12.42
Komponentët përbërës të ROA, ROA=AU-ER								
Shkalla e përdorimit të aktiveve (në %), AU=TOI/TA	9.90	8.46	8.66	8.08	8.15	7.70	8.24	8.76
Raporti i shpenzimeve (në %), ER=TOE/TA	8.32	7.26	7.42	6.80	6.75	6.34	6.76	7.85
Komponentët përbërës të ROA, ROA=NIM*EAR+B-LLP/TA-T/TA								
Marzhi neto i interesave (në %), NIM=NII/EA	3.35	2.91	3.23	3.08	3.75	4.22	4.35	4.13
Raporti i aktiveve që sjellin të ardhura me aktivet totale (në %), EAR=EA/TA	91.00	94.21	95.85	94.80	93.33	93.19	93.34	92.95
Barra e bankave (në %), B=NNII/TA	-0.77	-0.85	-1.11	-0.93	-1.45	-1.69	-1.62	-1.68
Raporti i shpenzimeve për provigjone ndaj totalit të aktiveve (në %), LLP/TA	0.23	0.33	0.25	0.26	0.19	0.48	0.53	1.05
Raporti i shpenzimeve për taksa dhe tatime ndaj totalit të aktiveve (në %), T/TA	0.47	0.35	0.50	0.45	0.46	0.41	0.44	0.18
Komponentët përbërës të NIM, NIM=REA-COL*LEA								
Kthimi nga aktivet që sjellin të ardhura (në %), REA=II/EA	8.39	7.73	8.07	6.96	6.84	7.05	7.72	8.06
Kosto mesatare e detyrimeve (në %), COL=IE/PL	5.33	5.17	5.23	4.14	3.28	3.05	3.70	4.30
Raporti i pasiveve që paguajnë interes me aktivet që sjellin të ardhura (në %), LEA=PL/EA	94.65	93.26	92.47	93.80	94.36	92.90	91.15	91.59

Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autores.

pasivet që shkaktojnë shpenzime) janë të mesatarizuara, ndërsa zërat e pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve janë kumulative përgjatë gjithë vitit.

Kthimi nga kapitali aksioner (ROE) është luhatur gjatë periudhës së analizuar, por përgjithësisht ka qëndruar në nivelet 19-23% (për vitet 2001-2007). Sidoqoftë, për vitin 2008 shihet qartë një rënie e theksuar e treguesit. Kjo rënie, (nëse do të niseshim thjesht nga ekuacioni (3)), është shkaktuar nga rënia e nivelit të të ardhurave neto që karakterizoi sistemin bankar gjatë vitit 2008, në krahasim me një vit më parë (pasi në vitet 2003-2007 të ardhurat neto kishin një trend rritës me një mesatare rritjeje prej 21% në vit). Rezultati neto i sistemit gjatë vitit 2008 rezulton në nivelin 7.3 miliardë lekë, me një rënie prej 26.5% nga një vit më parë. Nga ana tjetër, kapitali aksioner mesatar ka ardhur në rritje, por ritmi i rritjes ka qenë i ndryshëm në vite të ndryshme, me një normë mesatare prej 19% për periudhën 2002-2008. Rritja vjetore e kapitalit aksioner mesatar për fundvitin 2008 rezulton në nivelin 31.6%. Pikërisht prej këtyre dy dukurive, shpjegohet në pamje të parë rënia e treguesit ROE.



Megjithatë, le të shohim më në detaje se cili prej komponentëve përbërës të ROE, ka ndikuar më shumë në rënieën e tij (Grafik 1).

Marzhi i fitimit (të ardhurat neto/të ardhurat totale) ka ardhur në rritje që nga viti 2003, por në vitin 2008 ka një rënie të ndjeshme dhe është një nga faktorët kryesorë që kanë shkaktuar rënien e ROE. Në këtë përkeqësim ka ndikuar nga njëra anë rënia vjetore e rezultatit neto prej 26.5% dhe nga ana tjetër rritja e të ardhurave totale në po të njëjtën masë (26.5%). Rënia e marzhit të fitimit do të thotë se një pjesë më e vogël e të ardhurave totale mbetet në dispozicion të aksionerëve (për t'u shpërndarë si dividend) apo të bankës (për t'u rikapitalizuar), pas zbritjes së shpenzimeve.

Ndërkohë, shihet një rritje e lehtë e shkallës së përdorimit të aktiveve, nga 8.24% (në 2007) në 8.76% (në 2008). Meqenëse ky tregues ka luhatur të vogla në vite (është luhatur në nivelet 8-9% gjatë viteve 2002-2007), nuk pritet të ndikojë shumë në raportin e kthimit nga kapitali.

Shumëzuesi i kapitalit⁶ (EM) edhe në vitin 2008 ka vazhduar prirjen e tij rënëse, një tendencë kjo e nisur që në vitin 2005. Kjo dukuri ka ardhur si pasojë e rritjes vjetore më të shpejtë të kapitalit aksioner me mesatarisht 28% gjatë viteve 2005-2008, krahasuar me një rritje vjetore më të ulët të aktiveve mesatare prej 19% gjatë të njëjtës periudhë. Vlera e shumëzuesit të kapitalit në fund të vitit 2008 shpreh se aktivet mbulojnë mbi 12 herë kapitalin e investuar. Rritja vjetore e kapitalit aksioner mesatar me gati 32% për fundin e vitit 2008, është një tjetër dëshmi e masave të marra nga bankat për të rritur shkallën e kapitalizimit dhe për një menaxhim sa më të mirë në situatën e vështirë me të cilën u përball ekonomia botërore. Siç u shpreh edhe në seksionin 2.2, treguesi EM shërben për të llogaritur edhe një element tjetër të rëndësishëm, nivelin e hyrjes në borxh (detyrimeve) të sistemit bankar (shiko tabelën 3). Raporti i borxhit ka qenë në nivele pothuajse të pandryshueshme (çka tregon se detyrimet dhe aktivet totale të sistemit janë rritur me të njëjtën normë gjatë periudhës në fjalë), megjithatë shihet se treguesi ka pësuar një rënie të lehtë në vitet 2007-2008. Kjo mund të shpjegohet me faktin se bankat kanë preferuar të mbështeten më shumë në kapitalin e investuar nga aksionerët sesa në huamarrje, për më tepër që kjo e fundit është bërë më e vështirë dhe më e shtrenjtë në këto kohë të pasigurive financiare.

⁶ Në raportet vjetore të Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë gjendet me emërtimin "leva financiare".


Tabelë 3. Ecuria e raportit të borxhit (detyrimeve) të sistemit bankar shqiptar.

	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Niveli i detyrimeve (në %), 1-1/EM = Detyrime/Aktive mesatare	93.25	93.73	93.66	93.95	93.73	93.25	92.72	91.95

Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autores.


Deri tani mund të konkludohet se rënia e ROE në vitin e fundit, është shkaktuar kryesisht nga rënia e ndjeshme e marzhit të fitimit dhe nga rënia e shumëzuesit të kapitalit.

Në vazhdim do të zbërthehet treguesi i kthimit nga aktivet për të parë se cili prej nënzërave përbërës ka ndikuar më shumë në vlerën e tij dhe sidomos në rënien e tij gjatë vitit 2008 (shiko Grafikon 2).



Kthimi nga aktivet mesatare të sistemit bankar shqiptar (ROA) ka pasur vlera të kënaqshme gjatë viteve të fundit. Në përgjithësi ky tregues ka marrë vlera në intervalin 1.2-1.6% për vitet 2001-2007, por në vitin 2008 ka pasur një rënie të ndjeshme të tij në 0.9%. Duke parë ecurinë e të ardhurave dhe shpenzimeve totale në raport me aktivet mesatare, shihet se në përgjithësi ato kanë pasur të njëjtën tendencë nëpër vite përsa i takon kahut të lëvizjes, por jo madhësisë së saj. Në vitin 2008 shihet se ka një rritje si të të ardhurave ashtu edhe të shpenzimeve totale të sistemit bankar, por mesa duket shpenzimet janë rritur më shumë se të ardhurat, duke shkaktuar rënie të rezultatit neto dhe rrjedhimisht edhe të kthimit nga aktivet.

Për më tej, nga një tjetër transformim i treguesit ROA (Tabela 2), mund të merren rezultatet si në Grafikon 3.



Marzhi neto i interesave (NIM) është një tregues që shpreh nivelin e eficientës me të cilën bankat realizojnë ndërmjetësimin financiar. Gjatë periudhës së marrë në analizë, përgjithësisht ka shfaqur një tendencë rritëse, çka tregon se sistemi bankar shqiptar ka gjeneruar gjithmonë e më tepër të ardhura neto nga interesat në raport me aktivet që sjellin interes. Por në vitin 2008, sistemi bankar shqiptar ka ndeshur një rënie të marzhit neto nga interesat. Ndërsa në vitet 2005-2007 rritja vjetore e të ardhurave neto nga interesat ishte më e lartë sesa rritja vjetore e aktiveve që sjellin të ardhura (gjë që ka sjellë rritje të marzhit neto të interesave), për vitin 2008 këto raporte janë përbysur dhe shihet se rezultati neto nga interesat është rritur me vetëm 12%, ndërkohë që ndryshimi vjetor i aktiveve që sjellin të ardhura është 18%, duke rezultuar në një vlerë më të ulët të NIM. Kjo gjë kërkon një analizë më të hollësishme duke parë elementet që ndikojnë në të nga ana kontabël (gjë që do analizohet në vijim).

Sistemi bankar shqiptar ka qenë eficient në investimin e aktiveve të tij, pasi mesatarisht aktivet që sjellin të ardhura kanë zënë më shumë se 90% të aktiveve totale gjatë periudhës 2001-2008. Treguesi EAR ka rënë lehtë për vitin 2008, duke u identifikuar si një faktor që ka ndikuar në rënien e treguesit ROA dhe indirekt edhe të kthimit nga kapitali.

Ashtu siç pritej, barra e sistemit bankar shqiptar, rezulton negative. Bankat nuk kanë mundur të gjenerojnë mjaftueshëm të ardhura jo nga interesat sa për të mbuluar shpenzimet jo për interesa. Madje rezultati neto jo nga interesat⁷, që ka qenë negativ, është përkeqësuar si pasojë e ndikimit të disa faktorëve. Së pari, rezultati neto nga veprimtaritë e tjera është rritur në mënyrë të vazhdueshme, kur zërat kryesorë të të ardhurave dhe shpenzimeve nga veprimtaritë e tjera kanë qenë të ardhurat dhe shpenzimet nga komisionet dhe nga veprimtaria valutore. Në këtë mënyrë, mund të thuhet se ky zë ka ndikuar pozitivisht në rezultatin neto jo nga interesat. Por nga ana tjetër, edhe shpenzimet e veprimtarisë kanë ardhur në rritje dhe kanë ndikuar në përkeqësimin e rezultatit neto negativ, të siguruar jo nga interesat. Duhet theksuar se shpenzimet e veprimtarisë kanë ndjekur një rrjedhë normale rritjeje edhe në vitin 2008 ashtu si në vitet e mëparshme (me 23.5%), një rritje kjo e shkaktuar nga zgjerimi i veprimtarisë dhe shtrirjes gjeografike të sistemit bankar, ku shpenzimet e personelit zënë afro 40% të këtyre shpenzimeve.


Raporti i shpenzimeve për provigjone me aktivet mesatare ka qenë në nivele të ulëta (më pak se 0.5%) në vitet 2001-2007, por në vitin 2008 ka një rritje të menjëhershme të këtij raporti në 1.05%, pasojë e përkeqësimit të cilësisë së portofolit të kredisë. Rritja tepër e lartë e nivelit të shpenzimeve për provigjone gjatë 2008 (janë rritur gati 1.4 herë krahasuar me shpenzimet e 2007) si pasojë e përkeqësimit të portofolit të kredisë dhe e masave të marra nga sistemi bankar për të krijuar rezerva në kushtet e pasigurisë në rritje, ka tejkaluar rritjen vjetore të aktiveve mesatare të sistemit (19%), duke ndikuar negativisht në kthimin nga aktivet.

Shpenzimet për taksa dhe tatime të paguara nga bankat, kanë zënë mesatarisht vetëm 0.5% të aktiveve mesatare, dhe ky raport ka rënë në 0.2% për vitin 2008, duke ndikuar pozitivisht në kthimin nga aktivet. Rënia e vlerës absolute të këtyre shpenzimeve është shkaktuar si pasojë e rënies së rezultatit para taksave.

⁷ Përlllogaritur si Rezultati neto nga veprimtaritë e tjera + Rezultati neto i jashtëzakonshëm – Shpenzime të veprimtarisë.

Një mënyrë tjetër është: Të ardhura jo nga interesat – Shpenzime jo për interesa (shiko tabelën 5).

Si konkluzion, marzhi neto i interesave përgjithësisht ka ardhur në rritje dhe kjo tendencë ka ndryshuar lehtësisht kahun në vitin 2008. Për të shpjeguar këtë ecuri, do të analizohen elementet përbërëse të tij (shiko ekuacionin 14 dhe Grafikon 4).



Kthimi nga aktivet që sjellin të ardhura (REA) është një formë e matjes së interesit mesatar të fituar nga sistemi bankar, nga investimet në aktive fitimprurëse. Ky tregues ka ardhur në rritje në vitet e fundit, çka dëshmon se bankat e sistemit bankar shqiptar kanë filluar të investojnë në aktivitete me kthim më të lartë (por edhe me risk më të lartë, siç është për shembull kredia). Pavarësisht kësaj rritjeje, kthimi nga fondet e investuara, ka mbetur pothuajse në po të njëjtat nivele si në fillimin e periudhës së marrë në konsideratë.

Edhe kostoja e fondeve të huajtura (COL) ka ardhur në rritje për tre vitet e fundit të marrë në analizë, por krahasuar me fillimin e periudhës (vitin 2001) shihet se kjo kosto ka rënë me 1 pikë përqindje. Pjesa më e madhe e shpenzimeve për interesa shkojnë për interesa të paguara klientëve (për depozitat). Këto shpenzime janë rritur gjatë periudhës në fjalë jo vetëm si pasojë e rritjes së shumës së detyrimeve, por edhe pse normat e interesit u rritën dukshëm sidomos vitet e fundit (për shkak të rritjes graduale të normës bazë të interesit që nga viti 2005 dhe/ose politikës së bankave për të tërhequr vëmendjen e depozituesve ndaj ofertave sezonale).

Raporti i pasiveve që paguajnë interes me aktivet që sjellin të ardhura (LEA), nuk është luhatur shumë gjatë periudhës. Për vitin 2008 shihet një rritje e lehtë e raportit, por përgjithësisht gjatë gjithë periudhës së analizuar, më shumë se 90% e aktiveve fitimprurëse janë financuar nga pasive që paguajnë interes.

Përfundimisht mund të thuhet se rënia e marzhit neto të interesave për vitin 2008, vjen si pasojë e faktit se kthyeshmëria më e lartë nga aktivet mesatare që sjellin të ardhura (REA) nuk ka arritur të mbulojë efektin negativ të rritjes së kostos së fondeve të huajtura (COL) dhe të peshës së financimit të aktiveve fitimprurëse me pasive që paguajnë interes (LEA).

3. ANALIZA NË FORMË MATRICE E PERFORMANCËS SË SISTEMIT BANKAR

Një mënyrë alternative e analizimit të raporteve financiare të sistemit bankar, është edhe modeli matricor i prezantuar nga Vensel et al. (2004). Këta autorë kanë paraqitur një trajtim ndryshe të treguesve financiarë të sistemit bankar estonez, nëpërmjet krijimit të një matrice për analizimin e këtyre treguesve. Në këtë seksion do të paraqitet ndërtimi i matricës së raporteve financiare bazuar në modelin e autorëve të mësipërm, por me disa ndryshime për ta përshtatur me të dhënat financiare dhe raportet më të përdorshme për sistemin bankar shqiptar.

3.1 METODOLOGJIA

Vensel et al. (2004) thonë se duke u nisur nga n tregues sasiore Y_i ($i=1, 2, \dots, n$), mund të ndërtohen n^2 -n tregues cilësorë x_i (raporte financiare).

$$x_{ij} = \frac{Y_j}{Y_i} \quad (i, j = 1, 2, \dots, n; i \neq j) \quad (17)$$

Nga kombinimi i këtyre n treguesve sasiore, mund të ndërtohet matrica ($n \times n$), çka quhet ndryshe edhe model matricor.

$$X = \begin{pmatrix} x_{11} & x_{12} & \dots & x_{1n} \\ x_{21} & x_{22} & \dots & x_{2n} \\ \dots & \dots & \dots & \dots \\ x_{n1} & x_{n2} & \dots & x_{nn} \end{pmatrix} = \{x_{ij}\} \quad (18)$$

Kjo matricë (18) është simetrike sipas diagonales ku elementet simetrike janë të anasjelltë të njëri-tjetrit (raportet x_{ij} janë raporte të anasjellta të raporteve x_{ji}), dhe përbëhet nga dy matrica simetrike trekëndëshe: matrica e efikasitetit dhe matrica e anasjelltë e efikasitetit. Informacioni financiar i nevojshëm për analizë do të paraqitet në matricën e efikasitetit (elementet nën diagonalen), pa qenë nevoja të përlogariten të gjitha raportet financiare. Qëllimi i prezantimit të kësaj matrice është paraqitja dhe analiza e lidhjeve midis treguesve të ndryshëm financiarë.

Tërësinë e treguesve sasiorë që analizohen dhe përdoren për krijimin e raporteve të tjera financiare, mund t'i ndajmë në dy grupe nisur nga rëndësia e tyre ekonomike:

1. Treguesit burim (input) të veprimtarisë bankare, që merren nga bilanci dhe quhen të tillë sepse janë ata zëra të cilët, pasi vihen në funksionim nga bankat, arrijnë të gjenerojnë dhe të përmirësojnë rezultatet financiare. Ndër treguesit që përfshihen në këtë grup mund të përmenden: aktivet totale (TA), kapitali aksioner (BVE), aktivet që sjellin të ardhura (EA), pasivet që paguajnë interes (PL), etj.

2. Treguesit rezultat (output) të veprimtarisë bankare, që merren nga pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe quhen të tillë pasi janë rezultat i vënies në funksionim të burimeve të investuara. Ndër treguesit që përfshihen në këtë grup mund të përmenden: rezultati neto (EAT), të ardhurat totale (TOI), rezultati neto nga interesat (NII), të ardhura nga interesat (IR), të ardhura jo nga interesat (NIR), etj.

Kombinimi i këtyre dy grupeve të treguesve fillestarë formon matricën e efikasitetit të treguesve financiarë të sistemit bankar, e cila përmban tre matrica pjesore:

- Një nënmatricë trekëndëshe e quajtur “matrica rezultat”, elementet e së cilës paraqesin raporte të dy treguesve rezultat;
- Një tjetër nënmatricë trekëndëshe e quajtur “matrica burim”, elementet e së cilës paraqesin raporte të dy treguesve burim;
- Dhe së fundi, një nënmatricë katërkëndëshe e quajtur “matrica rezultat-burim”, elementet e së cilës paraqesin raporte të një treguesi rezultat me një tregues burim.

Matrica nr. 1

	Rezultati neto nga interesat (EAT) Y_1	Rezultati neto nga interesat (NII) Y_2	Të ardhura nga interesat (IR) Y_3	Të ardhura jo nga interesat (NIR) Y_4	Të ardhura totale (TO) Y_5	Aktive mesatare që sjellin të ardhura (EA) Y_6	Totali i aktiveve mesatare (TA) Y_7
Rezultati neto nga interesat (NII) Y_2	$x_{12} = Y_1 / Y_2$ Rezultati neto ndaj rezultatit neto nga interesat (NENII)						
Të ardhura nga interesat (IR) Y_3	$x_{13} = Y_1 / Y_3$ Rezultati neto ndaj të ardhurave nga interesat (NER)	$x_{23} = Y_2 / Y_3$ Raporti i rezultatit neto me të ardhurat totale nga interesat (NIR)					
Të ardhura jo nga interesat (NIR) Y_4	$x_{14} = Y_1 / Y_4$ Rezultati neto ndaj të ardhurave jo nga interesat (NENIR)	$x_{24} = Y_2 / Y_4$ Raporti i rezultatit neto nga interesat me të ardhurat totale jo nga interesat (NINIR)	$x_{34} = Y_3 / Y_4$ Raporti i të ardhurave nga interesat me të ardhurat jo nga interesat (NIR)				
Të ardhura totale (TO) Y_5	$x_{15} = Y_1 / Y_5$ Marzhi i fitimit (FM)	$x_{25} = Y_2 / Y_5$ Raporti i rezultatit neto nga interesat me të ardhurat totale (NITR)	$x_{35} = Y_3 / Y_5$ Raporti i të ardhurave nga interesat me të ardhurat totale (TIR)	$x_{45} = Y_4 / Y_5$ Raporti i të ardhurave jo nga interesat me të ardhurat totale (NIRTIR)			
Aktive mesatare që sjellin të ardhura (EA) Y_6	$x_{16} = Y_1 / Y_6$ Rezultati neto ndaj aktiveve që sjellin të ardhura (NREA)	$x_{26} = Y_2 / Y_6$ Marzhi neto i interesave** (NIM ₁)	$x_{36} = Y_3 / Y_6$ Kхими nga aktivet që sjellin të ardhura (REA)	$x_{46} = Y_4 / Y_6$ Të ardhura jo nga interesat ndaj aktiveve që sjellin të ardhura (NEA)	$x_{56} = Y_5 / Y_6$ Të ardhura totale ndaj aktiveve që sjellin të ardhura (TIEA)		
Totali i aktiveve mesatare (TA) Y_7	$x_{17} = Y_1 / Y_7$ Kхими nga aktivet (ROA)	$x_{27} = Y_2 / Y_7$ Marzhi neto i interesave** (NIM ₂)	$x_{37} = Y_3 / Y_7$ Të ardhura nga interesat ndaj aktiveve totale (IOA)	$x_{47} = Y_4 / Y_7$ Të ardhura jo nga interesat ndaj aktiveve totale (NIOA)	$x_{57} = Y_5 / Y_7$ Përdorimi i aktiveve (AU)	$x_{67} = Y_6 / Y_7$ Raporti i aktiveve që sjellin të ardhura me aktivet totale (EAR)	
Kapitali aksioner mesatar (BVE) Y_8	$x_{18} = Y_1 / Y_8$ Kхими nga kapitali aksioner (ROE)	$x_{28} = Y_2 / Y_8$ Rezultati neto nga interesat ndaj kapitalit aksioner (NIOE)	$x_{38} = Y_3 / Y_8$ Të ardhura nga interesat ndaj kapitalit aksioner (IOE)	$x_{48} = Y_4 / Y_8$ Të ardhura jo nga interesat ndaj kapitalit aksioner (NIOE)	$x_{58} = Y_5 / Y_8$ Të ardhura totale ndaj kapitalit aksioner (TIOE)	$x_{68} = Y_6 / Y_8$ Raporti i aktiveve që sjellin të ardhura me kapitalin aksioner (EAER)	$x_{78} = Y_7 / Y_8$ Shumëzësi i kapitalit (EM)

** Marzhi neto i interesave mund të matet në dy forma: Rezultat neto nga interesat në raport me Totalin e aktiveve që sjellin të ardhura (x_{26}) ose në raport me Totalin e aktiveve (x_{27}) (Kalluci 2010).

3.2 SHPJEGIME MBI KUPTIMIN E RAPORTEVE TË MATRICËS NR.1

Siç u diskutua edhe më sipër, nënmatrica “rezultat” vendos në raport elemente të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve. Një vlerë më e ulët e raportit NENII, tregon se rezultati neto përbën një pjesë më të ulët të rezultatit neto nga interesat, që është një situatë jo e pëlqyeshme, pasi dëshmon për shpenzime më të larta të veprimtarisë apo të provigjoneve, çka ul rezultatin neto.

Një raport më i lartë NIIR tregon se një pjesë më e lartë e të ardhurave nga interesat mbetet në dispozicion të bankës, pasi janë zbritur shpenzimet për interesa.

Raportet INIR, ITIR dhe NIRTIR na tregojnë mbi mënyrën e shpërndarjes së të ardhurave totale midis të ardhurave nga interesat dhe jo nga interesat.

Në përgjithësi, preferohet një vlerë e lartë e marzhit të fitimit (PM) që tregon se, pasi janë zbritur të gjitha shpenzimet, rezultati neto përbën një pjesë të konsiderueshme të të ardhurave totale.

Në nënmatricën “burim”, preferohet një tregues sa më i lartë EAR, pasi kjo nënkupton një investim të një pjese më të madhe të aktiveve në aktivitete fitimprurëse. Ndërsa për shumëzuesin e kapitalit (EM) mund të thuhet se sa më i lartë ky raport, aq më shumë bankat mbështeten në huamarrje për të financuar aktivitetin e tyre.

Nënmatrica “rezultat-burim” vendos në raport tregues të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve me tregues të bilancit, dhe në përgjithësi preferohen vlera sa më të larta për treguesit cilësorë. Në këtë mënyrë thuhet se përdorimi i treguesve burim ka qenë efektiv dhe ka arritur të gjenerojë rezultate të larta.

3.3 ANALIZA MATRICORE E PERFORMANCËS SË SISTEMIT BANKAR SHQIPTAR

Pas ndërtimit të matricës dhe përlllogaritjes së një sërë raportesh

financiare, mund të gjykohet mbi performancën e sistemit bankar. Në dallim nga modeli i modifikuar DuPont, duke përdorur matricën, mund të krijojmë më tepër raporte financiare dhe t'i paraqesim në mënyrë të përmbledhur, duke e bërë kështu më të thjeshtë krahasimin.

Në matricën nr. 2 janë paraqitur 28 tregues (raporte) financiare për vitet 2001, 2005 dhe 2008. Në këtë mënyrë, mund të ndërtohen një sërë matricash me tregues të viteve të ndryshëm që mund të krahasohen midis tyre.

Në "matricën rezultat", elementi themelor është x_{15} - PM (marzhi i fitimit), i cili mund të shprehet si kombinim i një sërë treguesish të tjerë:

$$x_{15} = x_{12} * x_{23} * x_{34} * x_{45} \quad (19)$$

ose

$$PM = NENII * NIIR * INIR * NIRTIR = \frac{EAT}{NII} * \frac{NII}{IR} * \frac{IR}{NIR} * \frac{NIR}{TOI} = \frac{EAT}{TOI} \quad (20)$$

Nisur nga lidhjet e mësipërme, mund të krijojmë kombinime të shumëllojshme që mund të përdoren për të identifikuar faktorët që ndikojnë më shumë në një element të caktuar të matricës (apo në rritjen ose uljen e tij krahasuar me një periudhë të mëparshme).

Për shembull, nëse $PM_{08} / PM_{01} = 0.652$, kjo mund të shprehet si kombinim i normave të rritjes së gjithë elementeve përbërëse të PM për periudhën 2001-2008 (shiko ekuacionin 19 dhe matricën nr. 2), përkatësisht:

$$\frac{PM_{08}}{PM_{01}} = \frac{NENII_{08}}{NENII_{01}} * \frac{NIIR_{08}}{NIIR_{01}} * \frac{INIR_{08}}{INIR_{01}} * \frac{NIRTIR_{08}}{NIRTIR_{01}} = 0.459 * 1.281 * 1.757 * 0.631 = 0.652 \quad (21)$$

Në këtë mënyrë, mund të gjykohet se elementi që ka ndikuar më shumë në rënien e PM për periudhën 2001-2008 është treguesi NENII. Më pas mund të vazhdohet me zbërthimin e këtij të fundit në elemente përbërëse, për një analizë më të detajuar të situatës dhe shkaqeve që e sjellin atë.

Në “matricën burim”, si element bazë merret x_{68} – EAER (raporti i aktiveve që sjellin të ardhura me kapitalin aksioner), që mund të shprehet si kombinim i dy treguesve të tjerë rezultat:

$$x_{68} = x_{67} * x_{78} \quad (22)$$

ose

$$EAER = EAR * EM = \frac{EA}{TA} * \frac{TA}{BVE} = \frac{EA}{BVE} \quad (23)$$

Në të njëjtën mënyrë mund të realizohen analiza për faktorët që mund të kenë ndikuar në rënien e EAER (gjatë 2001-2008), ku shihet se shkaktari i kësaj rënieje është shumëzuesi i kapitalit (EM).

Së fundmi, në “matricën rezultat-burim” elementi bazë që mund të shprehet si një kombinim i shumë faktorëve të tjerë, është x_{18} – ROE (raporti i kthimit nga kapitali aksioner), i cili më konkretisht mund të shprehet:

$$x_{18} = x_{12} * x_{23} * x_{34} * x_{45} * x_{56} * x_{67} * x_{78} \quad (24)$$

ose

$$ROE = NENII * NIIR * INIR * NIRTIR * TIEA * EAR * EM = \frac{EAT}{NII} * \frac{NII}{IR} * \frac{IR}{NIR} * \frac{NIR}{TOI} * \frac{TOI}{EA} * \frac{EA}{TA} * \frac{TA}{BVE} = \frac{EAT}{BVE} \quad (25)$$

Përsëri, mund të identifikojnë si më poshtë, faktorët që kanë shkaktuar rënien e ROE:

$$\begin{aligned} \frac{ROE_{08}}{ROE_{01}} &= \frac{NENII_{08}}{NENII_{01}} * \frac{NIIR_{08}}{NIIR_{01}} * \frac{INIR_{08}}{INIR_{01}} * \frac{NIRTIR_{08}}{NIRTIR_{01}} * \frac{TIEA_{08}}{TIEA_{01}} * \frac{EAR_{08}}{EAR_{01}} * \frac{EM_{08}}{EM_{01}} = \\ &= 0.459 * 1.281 * 1.757 * 0.631 * 0.866 * 1.021 * 0.839 = 0.484 \end{aligned} \quad (26)$$

Ashtu siç u tha edhe më lart, është rënia e raportit NENII, faktori që ka ndikuar më shumë në rënien e ROE për vitin 2008, krahasuar me 2001. Faktorë të tjerë që kanë ndikuar negativisht janë edhe rënia e NIRTIR, TIEA dhe EM. Në të njëjtën formë mund të vazhdohet të analizohen shkaqet e ndryshimeve të treguesve nëpër vite.

Matrica nr. 2

	Rezultati neto (EAT) Y ₁	Rezultati neto nga interesat (NII) Y ₂	Të ardhura nga interesat (IR) Y ₃	Të ardhura jo nga interesat (NIR) Y ₄	Të ardhura totale (TOI) Y ₅	Aktive mesatare që sjellin të ardhura (EA) Y ₆	Totali i aktiveve mesatare (TA) Y ₇
Rezultati neto nga interesat (NII) Y ₂	NENII 51.9% (2001) 40.2% (2005) 23.8% (2008)						
Të ardhura nga interesat (IR) Y ₃	NEIR 20.7% (2001) 22.0% (2005) 12.2% (2008)	NIIR 39.9% (2001) 54.8% (2005) 51.2% (2008)					
Të ardhura jo nga interesat (NIR) Y ₄	NENIR 69.9% (2001) 79.4% (2005) 72.2% (2008)	NINIR 134.5% (2001) 197.5% (2005) 302.8% (2008)	INIR 336.9% (2001) 360.5% (2005) 591.9% (2008)				
Të ardhura totale (TOI) Y ₅	PM 1.6% (2001) 17.2% (2005) 10.4% (2008)	NITIR 30.8% (2001) 42.9% (2005) 43.8% (2008)	ITIR 77.1% (2001) 78.3% (2005) 85.5% (2008)	NIRTIR 22.9% (2001) 21.7% (2005) 14.5% (2008)			
Aktive mesatare që sjellin të ardhura (EA) Y ₆	NREA 1.7% (2001) 1.5% (2005) 1.0% (2008)	NIM ₁ 3.4% (2001) 3.7% (2005) 4.1% (2008)	REA 8.4% (2001) 6.8% (2005) 8.1% (2008)	NIEA 2.5% (2001) 1.9% (2005) 1.4% (2008)	TIEA 10.9% (2001) 8.7% (2005) 9.4% (2008)		
Totali i aktiveve mesatare (TA) Y ₇	ROA 1.6% (2001) 1.4% (2005) 0.9% (2008)	NIM ₂ 3.0% (2001) 3.5% (2005) 3.8% (2008)	IOA 7.6% (2001) 6.4% (2005) 7.5% (2008)	NIOA 2.3% (2001) 1.8% (2005) 1.3% (2008)	AU 9.9% (2001) 8.2% (2005) 8.8% (2008)	EAR 91.0% (2001) 93.3% (2005) 93.0% (2008)	
Kapitali aksioner mesatar (BVE) Y ₈	ROE 23.4% (2001) 22.4% (2005) 11.4% (2008)	NIIOE 45.1% (2001) 55.8% (2005) 47.6% (2008)	IOE 113.1% (2001) 101.9% (2005) 93.1% (2008)	NIOE 33.6% (2001) 28.3% (2005) 15.7% (2008)	TIOE 146.6% (2001) 130.1% (2005) 108.8% (2008)	EAER 13.47 (2001) 14.89 (2005) 11.55 (2008)	EM 14.81 (2001) 15.96 (2005) 12.42 (2008)

4. INDEKSI I RREZIKUT

Në përgjithësi, teoria financiare i shikon kthimet në raport me rrezikun, pasi një rrezik më i lartë kërkon që të kompensohet nga kthime më të larta, në mënyrë që të ndërmerret nga aksionerët risk-kundërshtues. Në seksionin e mëparshëm u analizua performanca e sistemit bankar shqiptar; tanimë do të përlllogaritet niveli i rrezikut me të cilin ndeshet ky sistem gjatë ushtrimit të aktivitetit të vet ndërmjetësues. Bankat përballen me rreziqe që janë karakteristike për veprimtarinë bankare, të tilla si rreziku i kredisë, i normave të interesit, i likuiditetit, i kursit të këmbimit, operacional etj. Përveç treguesve të veçantë të formuar për të matur secilin prej rreziqeve të mësipërme, mund të krijohet një "Indeks Rreziku" që i përfshin të gjitha këto rreziqe në një indeks të vetëm.

4.1 METODOLOGJIA

Indeksi i rrezikut (i njohur në literaturë edhe si statistika Z, indeksi Z apo vlera Z) është një tregues i nivelit të përgjithshëm të rrezikut që bankat ndeshin. Vitet e fundit, ky indeks që shërben si një matës i shëndetit dhe qëndrueshmërisë së institucioneve financiare, ka marrë një rëndësi më të madhe. Indeksi i rrezikut lidhet në mënyrë të anasjelltë me probabilitetin e paafësisë paguese të këtyre institucioneve. Në literaturë gjenden variante të ndryshme të përlllogaritjes së tij, si për banka individuale, ashtu edhe për grupe bankash (sipas pronësisë, fushës së aktivitetit, apo për sisteme bankare të vendeve të caktuara). Llogaritja e këtij indeksi është bërë për herë të parë nga Hannan dhe Hanweck (1988)⁸, që në punimin e tyre kanë derivuar probabilitetin e paafësisë paguese⁹ (probabilitetin që humbjet e periudhës të tejkalojnë vlerën kontabël të kapitalit të bankës, apo probabilitetin që vlera e aktiveve të bankës të jetë më e ulët sesa detyrimet e saj).

Nëpërmjet kombinimit të kthimit nga aktivet (ROA), shumëzuesit të kapitalit (EM) dhe devijimit standard të ROA, mund të njehsojmë Indeksin e Rrezikut. Forma empirike e këtij indeksi është:

⁸ Më pas është aplikuar nga Liang dhe Savage (1990), Eisenberg dhe Kwast (1991), Sinkey dhe Nash (1993), Nash dhe Sinkey (1997), Naïmy (2005) etj.

⁹ Në terma të vlerave kontabël dhe jo atyre të tregut.

$$RI = \frac{E(ROA) + CAP}{\sigma_{ROA}} \quad (27)$$

ku:

RI – është Indeksi i Rrezikut (i quajtur edhe statistika, indeksi apo vlera Z)

E(ROA) - është kthimi mesatar nga aktivet (vlera e pritur)

CAP = EM^{-1} - është raporti i kapitalit mesatar me aktivet mesatare

σ_{ROA} - është devijimi standard i ROA

Ndërsa probabiliteti i paaftësisë paguese (Π) matet:

$$\Pi = \frac{1}{2 * RI^2} \quad (28)$$

“Indeksi i rrezikut (vlera - Z) tregon numrin e devijimeve standarde nën mesataren me të cilin duhet të bien fitimet kontabël të një banke (apo të sistemit) derisa të eliminohet kapitali aksioner” (Eisenberg dhe Kwast, 1991); pra shpreh aftësinë e një banke për të mbuluar humbjet kontabël.

Duhet thënë se nuk ka një vlerë apo një interval që të shërbejë si etalon për indeksin e rrezikut, pra për të kuptuar nëse një sistem bankar (bankë) është në situatë më të sigurt apo më të rrezikshme. Përgjithësisht, indeksi shihet në ecurinë e tij; ku një ecuri në rritje e tij është një shenjë e mirë, ndërsa rënia tregon për një zhvillim negativ. Jordan (1998) bën dallimin për vlerën Z midis bankave që mbijetuan dhe atyre që falimentuan gjatë viteve 1989-1992 në New England, periudhë kjo kur industria bankare e këtij rajoni përjetoj probleme serioze. Ai ka dalë në përfundimin se grupi i bankave që mbijetuan kishin një vlerë mesatare më të lartë të indeksit Z prej 13.33 e rrjedhimisht një probabilitet më të ulët paaftësie paguese, krahasuar me bankat që falimentuan ($Z=8.71$). Beck dhe Leaven (2006) kanë matur vlerën Z për 57 vende dhe kanë gjetur diferenca midis tyre. Ata llogaritin për vitet 1997-2003 një vlerë mesatare të indeksit Z (për bankat e përfshira në studim) prej afro 50 njësi për rastin e Shteteve të Bashkuara, por vetëm afro 2 njësi për Korenë dhe 11.6 njësi për Shqipërinë, ndërkohë që mesatarja e 57 shteteve ishte 24. Hesse dhe Čihák (2007) kanë llogaritur indeksin Z për bankat individuale të 29 shteteve të zhvilluara dhe në zhvillim të OECD për vitet 1994-2004, dhe kanë arritur në përfundimin se bankat kooperativë kanë vlera më të larta të indeksit (mesatarja

e grupit të këtyre bankave është 59.6) sesa bankat e kursimeve (55.4) dhe ato tregtare (46.5), duke treguar se të parat janë më të qëndrueshme. Čihák (2007), duke përdorur një grup prej 29 vendesh, 12 prej të cilave kanë përjetuar kriza bankare sistemike, ka gjetur se bankat në krizë karakterizohen nga vlera ndjeshëm më të ulëta ($Z=32$) sesa banka të tjera ($Z=89$).

Evidencat ndërkombëtare tregojnë se vlerat e indeksit të rrezikut variojnë sipas vendeve dhe/ose llojit të bankave. Prandaj, kur të llogaritet indeksi për Shqipërinë, do të gjykohet për të në bazë të tendencës dhe jo të vlerës absolute. Një nivel i ulët i indeksit nënkupton një bankë më të rrezikuar, dhe një vlerë e lartë do të thotë një bankë më e sigurt. Meqenëse është i lidhur në mënyrë të anasjelltë me probabilitetin Π , një vlerë më e lartë e indeksit tregon për shanse më të ulëta që banka të ndodhet në vështirësi paguese.

Nëse një bankë (sistem bankar) ka një nivel të lartë të kthimit nga aktivet, nivel të lartë të kapitalizimit dhe një luhatshmëri më të ulët të kthimit nga aktivet, atëherë banka (sistemi bankar) konsiderohet si më i sigurt (ka një indeks rreziku më të lartë). Jo pa qëllim janë përdorur te indeksi këto tre elemente përbërëse, pasi secili prej tyre ka një domethënie të veçantë; vetë treguesi ROA shërben si matësi më i mirë i performancës së bankave (siç u diskutua në seksionet e mëparshme), luhatshmëria e tij është një matës standard i rrezikut në financë dhe niveli i kapitalizimit përfaqëson një standard për qëndrueshmërinë dhe sigurinë e bankave.

4.2 LLOGARITJA E INDEKSIT TË RREZIKUT PËR SISTEMIN BANKAR SHQIPTAR

Për rastin e Shqipërisë, indeksi i rrezikut është llogaritur në pak punime nga autorë të tjerë¹⁰, por në kuadrin e studimeve të bëra për një grup vendesh dhe jo veçanërisht për sistemin bankar shqiptar. Duhet theksuar se ka dallime midis trajtimit që do të bëhet në vijim dhe studimeve të këtyre autorëve, përse i takon vlerës së llogaritur të

¹⁰ Beck dhe Leaven (2006); Ariss (2009); Agoraki et al. (2009).

indeksit, për shkak të përfshirjes së periudhave të ndryshme kohore në studim. Për më tepër, në studimet e tjera, të dhënat i përkasin vetëm disa prej bankave të sistemit bankar shqiptar (pasqyrat financiare të të cilave gjenden në Bankscope). Për herë të parë në këtë punim është përlllogaritur indeksi i rrezikut për të gjithë sistemin bankar shqiptar dhe është krijuar një seri kohore e vlerave të tij përgjatë periudhës dhjetor 2001- qershor 2009. Të dhënat janë tremujore dhe fillimisht ato janë marrë për banka të veçanta. Më pas, për të llogaritur treguesit përbërës të indeksit, të dhënat janë agreguar për gjithë sistemin, si mesatare të ponderuara të të dhënave individuale (peshat që zënë aktivet e çdo banke ndaj totalit të aktiveve të sistemit bankar, u përdorën si faktorë ponderues).

Në literaturë, gjenden dy metoda kryesore sesi autorë të ndryshëm kanë përlllogaritur vlerën mesatare dhe devijimin standard të ROA, që përdoren në matjen e indeksit të rrezikut. E para llogarit vlerën e pritur (mesatare), si mesatare të vlerave të ROA përgjatë një periudhe kohore, prej së cilës derivohet edhe devijimi standard i vlerave, gjatë së njëjtës periudhë. Kjo metodë është më e përshtatshme nëse do përlllogaritet indeksi i rrezikut përgjatë një periudhe kohe dhe kur flitet për një bankë apo sistem bankar të veçantë.

Mënyra e dytë është të llogaritet vlera mesatare e ROA në një moment në kohë, duke përdorur mesataren e ponderuar të ROA-s të çdo banke individuale; devijimi standard është devijimi standard midis bankave. Kjo mënyrë është më e aplikueshme në rastet kur duam të krijojmë një seri kohore të indeksit të rrezikut dhe kur kemi të bëjmë me një sistem bankar që shihet si i përbërë nga banka individuale, peshat e aktiveve të të cilave shërbejnë si faktorë ponderues për llogaritjen e vlerës mesatare dhe devijimit standard të ROA, në një çast kohe.

Meqenëse indeksi i rrezikut po llogaritet për herë të parë për rastin e Shqipërisë, dhe qëllimi kryesor është të ndërtohet një seri për të parë ecurinë e indeksit, në këtë punim do të përdoret metodën e dytë. Megjithatë, përdoruesit e mëpasshëm të këtij matësi të rrezikut, mund të provojnë të llogaritin edhe vlerën e indeksit për një hark kohor sipas përshkrimit të mënyrës së parë.

Vlera e pritur e ROA-s së sistemit për çdo tremujor, është llogaritur si mesatare e ponderuar e ROA-s të çdo banke¹¹ në fund të tremujorit, e ponderuar me peshën që aktivet e kësaj banke zënë ndaj aktiveve totale të sistemit në fund të periudhës përkatëse (ekuacioni 29).

$$E(ROA)_t = \sum(ROA_{it} * w_{it}) \quad (29)$$

ku:

$E(ROA)_t$ - është kthimi mesatar (i pritshëm) nga aktivet për sistemin bankar, në tremujorin t;

ROA_{it} - është kthimi nga aktivet e bankës i për tremujorin t, e kthyer në terma vjetorë;

w_{it} - është pesha e aktiveve të bankës i ndaj aktiveve totale të sistemit bankar për tremujorin t;

i - qëndron për bankën e i-të të sistemit dhe t për tremujorin e t-të.

Devijimi standard është përlllogaritur sipas ekuacionit (30):

$$\sigma(ROA)_t = \sqrt{\sum[ROA_{it} - E(ROA)_t]^2 * w_{it}} \quad (30)$$

Në tabelën 4, paraqiten rezultatet e marra nga përlllogaritja e Indeksit të Rrezikut dhe të probabilitetit të paaftësisë paguese për sistemin bankar shqiptar, për vitet 2001-2008.

Tabelë 4: *Indeksi i rrezikut dhe probabiliteti i paaftësisë paguese për sistemin bankar shqiptar.*


	Dhjetor 2001	Dhjetor 2002	Dhjetor 2003	Dhjetor 2004	Dhjetor 2005	Dhjetor 2006	Dhjetor 2007	Dhjetor 2008
Indeksi i Rrezikut (RI)	9.0	10.9	7.8	9.2	7.3	5.8	9.4	7.2
Mesatarja për vlerat e muajit dhjetor '01-'08	8.3	8.3	8.3	8.3	8.3	8.3	8.3	8.3
Probabiliteti i paaftësisë paguese (ra)	0.61%	0.42%	0.83%	0.59%	0.95%	1.48%	0.56%	0.96%

Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autoreos.


¹¹ Zakonisht, për të llogaritur vlerën e pritur, si faktorë ponderues shërbejnë probabilitetet e ndodhjes së një ngjarjeje. Meqenëse nuk kemi probabilitetet e shpërndarjes së vlerave të parashikuara për të ardhmen, supozohet se vlera e pritur e ROA-s së sistemit mund të përafrohet me mesataren e ponderuar të të gjithë vlerave aktuale të ROA-s për secilën bankë.

Indeksi i rrezikut për sistemin bankar shqiptar ka pësuar luhatje në kohë, por niveli mesatar i tij gjatë periudhës 2001-2008 (nëse merren parasysh vlerat e muajit dhjetor të çdo viti) ka arritur në 8.3. Në fundin e vitit 2008, vlera e tij ka qenë më e ulët sesa mesatarja e këtyre tetë viteve. Madje në tremujorin e parë të 2009, vlera e indeksit ka rënë në 5.1, duke reflektuar edhe problemet me të cilat u ndeshën tregjet financiare në mbarë botën. Kështu, rrezikshmëria në sistemin bankar shqiptar u rrit. Por në tremujorin e dytë të vitit, shihet një përmirësim i indeksit, që flet për një situatë më optimiste. Kjo shkon në linjë edhe me parashikimet e bankave tregtare për një gjallërim në aktivitetin e tyre, si dhe me një rikthim të besimit të publikut në sistemin bankar.

Në përgjithësi, raporti i kapitalit aksioner me aktivet mesatare, ka ardhur në rritje (çka ka ndikuar pozitivisht në indeksin e rrezikut). Elementi që ka ndikuar në rënie e indeksit është vlera e mesatares së ponderuar të ROA-s të sistemit, e cila ka rënë shumë ndjeshëm sidomos gjatë tre tremujorëve që paraprinë tremujorin e dytë të 2009. Në këtë tremujor shihet një përmirësim në vlerën mesatare të ROA-s, që ka ndikuar pozitivisht në rritjen e vlerës së indeksit. Por edhe luhatshmëria më e lartë e ROA-s, ka ndikuar në përkeqësimin e indeksit të rrezikut në fundin e vitit 2008 dhe në tremujorin e parë të 2009. Për tremujorin e dytë edhe devijimi standard ka pësuar rënie, gjë që është reflektuar në përmirësimin e indeksit të rrezikut (shiko Grafikonin 5).



Duke parë rezultatet nga ana tjetër, probabiliteti që kapitali aksioner i sistemit bankar shqiptar të bëhet negativ, është në vlera të ulëta duke u luhatur rreth vlerës 1-2%, për periudhën e marrë në konsideratë. Pavarësisht se probabiliteti i paaftësisë paguese u rrit gjatë periudhës së krizës financiare globale (si pasojë e rënies së vlerës së indeksit të rrezikut), vlera e tij e ulët nuk përbën shqetësim për sistemin bankar shqiptar (shiko Grafikon 6).



5. PËRFUNDIME

Sistemi bankar shqiptar në vitet e fundit është karakterizuar nga një zgjerim i shpejtë i aktivitetit të tij, që shihet në rritjen e totalit të aktiveve, portofolit të kredisë, depozitave të grumbulluara, gamës së produkteve dhe shërbimeve të ofruara në kuadrin e rritjes së konkurrencës, të ardhurave neto dhe treguesve të tjerë sasiorë e cilësorë. Në vitet 2001-2007, sistemi bankar shqiptar përgjithësisht ka gjeneruar norma të larta të kthimit nga kapitali dhe nga aktivet, duke u renditur ndër vendet e para të rajonit. Kjo dëshmon edhe njëherë se përfshirja e bankave shqiptare në aktivitete me rrezik më të lartë, ka mundësuar edhe gjenerimin e rezultateve të larta financiare. Megjithatë, në vitin 2008 kur ekonomia globale u përfshi e gjitha nga kriza financiare, edhe për sistemin bankar shqiptar, vihen re shenja ngadalësimi të aktivitetit dhe përkeqësimi të indikatorëve financiarë. Kthimi nga kapitali u ul ndjeshëm dhe kjo si pasojë e rënies së dy faktorëve kryesorë përbërës së tij, shumëzuesit të kapitalit dhe kthimit nga aktivet. Ky i fundit u zvogëlua si pasojë e uljes së marzhit neto të interesave dhe raportit të aktiveve që sjellin të ardhura si dhe nga pamundësia e bankave për të mbuluar shpenzimet jo për interesa me të ardhura jo nga interesat, dhe nga rritja në raportin e shpenzimeve për provigjone ndaj aktiveve totale. Marzhi neto i interesave ka rënë gjatë vitit 2008, si pasojë e rritjes së kostos së fondeve të huajtura dhe e shkallës së financimit të aktiveve që sjellin të ardhura nga pasivet që paguajnë interes.

Ky punim gjithashtu paraqiti për herë të parë një seri kohore tremujore të vlerave të indeksit të rrezikut të llogaritur për të gjithë sistemin bankar shqiptar përgjatë periudhës dhjetor 2001-qershor 2009. Indeksi ka shfaqur nivele të larta gjatë periudhës së analizuar, mbështetur nga kthime të larta nga aktivet dhe një sistem i mirëkapitalizuar, si dhe nga luhatshmëri të ulëta të treguesit ROA. Gjithsesi, në momentin kur kriza financiare globale kulmoi, edhe indeksi i rrezikut të sistemit bankar shqiptar u përkeqësua, si pasojë e kushteve të tregjeve financiare.

Ky studim, më tepër se një analizë të treguesve financiarë të kthimit dhe rrezikut për sistemin bankar shqiptar, synoi të sjellë disa

tregues të rinj të matjes së rrezikut dhe performancës, të zbërthyer dhe të analizuar në një këndvështrim të ri, për t'u ardhur në ndihmë mbikëqyrësve në analizat periodike të sistemit bankar.

Puna e mëtejshme mund të fokusohet në pasurimin e serisë së këtyre treguesve të rinj, dhe në drejtim të identifikimit të faktorëve që ndikojnë treguesit ROE dhe ROA me ndihmën e përdorimit të modeleve ekonometrike. Veç kësaj, për indeksin e rrezikut, shtimi në kohë i bazës së të dhënave, mund të krijojë mundësinë e testimit të cilësisë së indeksit të përdorur dhe llogaritjen e tij edhe përgjatë një periudhe kohe, jo thjesht për çdo tremujor.


REFERENCAT

1. Agoraki, Maria-Eleni, Delis, Manthos D. and Pasiouras, Fotios (2009), "Regulations, competition and bank risk-taking in transition countries". MPRA Paper, Unpublished.
2. Ariss Rima T. (2009), "On the implications of market power in banking: Evidence from developing countries", *Journal of Banking and Finance*.
3. Banka e Shqipërisë, Raporte vjetore të Mbikëqyrjes Bankare, 2001-2007.
4. Beck, T. and L. Laeven (2006), "Resolution of Failed Banks by Deposit Insurers: cross-country Evidence", *World Bank Policy Research Working Paper*, no. 3920.
5. Blumenthal Robin G. (1998), 'Tis the Gift to Be Simple - Why the 80-year-old DuPont model still has fans.", *CFO Magazine*, January 1998.
6. Čihák, M. (2007), "Systemic Loss: A measure of financial stability.", *Czech Journal of Economics and Finance*, Vol. 57.
7. Cole, David W. (1972), "Return on Equity Model for Banks", *The Bankers Magazine*, Vol. 155.
8. Eisenbeis, R.A. and Kwast, M.L. (1991), "Are Real Estate Depositories Viable? Evidence from Commercial Banks," *Journal of Financial Services Research*, March.
9. Hannan, T.H. and Hanweck, G.A. (1988), "Bank Insolvency Risk and the Market for Large Certificates of Deposit," *Journal of Money Credit and Banking*, Vol. 20, No. 2, May.
10. Hesse, H. and Čihák, M. (2007), "Cooperative Banks and Financial Stability", *IMF Working Paper*, WP/07/2.
11. Jordan John S., (1998), "Problem loans at New England banks, 1989 to 1992: evidence of aggressive loan policies", *New England Economic Review*, January/February.
12. Kalluci, Irini. (2010), "Përcaktuesit e marzhit neto të interesave në sistemin bankar shqiptar", *Seria e Materialeve të Diskutimit 2010*, Banka e Shqipërisë.


- x13. Kimball, Ralph (1997), "Specialization, Risk, and Capital in Banking." *New England Economic Review*, November/December.
14. Koch, Timothy W. and MacDonald, Scott S., (2002). "Bank Management" 5-th edition.
15. Liang, J.N. and Savage, D.T. (1990), "The Nonbank Activities of Bank Holding Companies," *Federal Reserve Bulletin*, May.
16. Naïmy, V. (2005), "Overall Lebanese Banks' Performance: A Risk – Return Framework", *International Business & Economics Research Journal*, January.
17. Sinha, Pankaj, Taneja Varundeeep Singh and Gothi, Vineet (2009), "Evaluation of riskiness of Indian Banks and probability of book value insolvency", MPRA Paper No.15251, University Library of Munich, Germany.
18. Sinkey J. Jr. (2002), *Commercial Bank Financial Management in the Financial-Services Industry*, Sixth Edition, Prentice Hall.
19. Sinkey, J.F. Jr., Nash, R.C. (1993), "Assessing the Riskiness and Profitability of Credit-Card Banks," *Journal of Financial Services Research*, June, Volume 7, Number 2.
20. Vensel V., Aarma, A., Vainu J., (2004), "Bank Performance Analysis: Methodology and Empirical Evidence (Estonian Banking System, 1994-2002)", Working Paper Series.
21. Walker John S., (2007), "Using the Du Pont Equation to Improve Your Bank's Performance", *Ambassador Financial Group Inc. Research*, October 2007.

SHTOJÇË

Grafik 7. Shpërndarja e kthimit nga kapitali sipas numrit të bankave të sistemit bankar shqiptar.



Grafik 8. Shpërndarja e kthimit nga aktivet sipas numrit të bankave të sistemit bankar shqiptar.



Tabelë 5: Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për sistemin bankar shqiptar (në milionë lekë).

	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008
Të ardhura nga interesat (1)	22,446	23,538	27,838	26,394	29,961	35,989	48,636	60,159
Shpenzime për interesa (2)	13,484	14,691	16,688	14,731	13,549	14,452	21,222	29,381
Të ardhura neto nga interesat (3) = (1)-(2)	8,962	8,847	11,150	11,663	16,412	21,537	27,413	30,778
Të ardhura jo nga interesat (të ardhura nga veprimtari të tjera + të ardhura të jashtëzakonshme) (4)	6,662	3,820	3,341	5,915	8,310	6,187	6,962	10,164
Shpenzime jo për interesa (shpenzime për veprimtari të tjera + shpenzime të veprimtarisë + shpenzime të jashtëzakonshme) (5)	8,930	6,568	7,326	9,622	15,092	15,428	17,892	23,684
Të ardhura neto jo nga interesat (6) = (4)-(5)	(2,268)	(2,748)	(3,985)	(3,706)	(6,782)	(9,241)	(10,930)	(13,520)
Shpenzime për provigjone (7)	668	1,063	908	1,039	869	2,615	3,544	8,454
Taksa dhe tatime (tatime përveç tatimit mbi të ardhurat + tatimi mbi të ardhurat) (8)	1,372	1,142	1,802	1,811	2,163	2,230	2,962	1,468
Rezultati neto (9) = (3) + (6) - (7) - (8)	4,654	3,894	4,455	5,106	6,598	7,451	9,978	7,336

Burimi: Banka e Shqipërisë, llogaritje të autores.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Irini Kalluci

Analizë e sistemit bankar shqiptar nën
këndvështrimin rrezik – performancë- /
/ Kalluci Irini - Tiranë:
Banka e Shqipërisë, 2011

-48 f; 15.3 x 23 cm. (material diskutimi ..)

Bibliogr.

ISBN: 978-99956-42-39

Këtë publikim mund ta gjeni edhe në formë elektronike në adresën:

www.bankofalbania.org

*Në qoftë se dëshironi të keni kopje të
shkruara të tij mund t'i kërkonit në adresën:*

*Banka e Shqipërisë
Sheshi "Avni Rustemi", Nr. 24, Tiranë, Shqipëri
Tel.: + 355 4 2419301/2/3; + 355 4 2419409/10/11
Faks: + 355 4 2419408
ose duke dërguar një e-mail në adresën:*

public@bankofalbania.org

Tirazhi: 500 kopje